VENDIM
Nr. 166, datë 25.2.2015

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 25.3.2014, PËR ÇËSHTJEN "MEMISHAJ KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR ANKIMIN NR. 40430/08)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.3.2014, për çështjen "Memishaj kundër Shqipërisë" (për ankimin nr. 40430/08), në shumën 4 700 (katër mijë e shtatëqind) euro, në lidhje me dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme, si dhe shumën prej 3 000 (tre mijë) eurosh, në lidhje me kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.
2. Vlera, e përcaktuar si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.
3. Vlera, e përcaktuar si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z. Enver Memishaj, në shumën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.3.2014, për çështjen "Memishaj kundër Shqipërisë".
4. Pagesa e shumës së depozituar, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesit, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor, për kryerjen e pagesave, nga buxheti i shtetit, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.
5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme të paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind.
6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës.
7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama